



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KONSULTATIV I BIZNESIT

VENDIM

Nr. 3, datë 06.03.2008

Për

**Miratimin e Raportit Vjetor të Këshillit Konsultativ të Biznesit për vitin 2007 dhe të
Buxhetit të vitit 2008 të këtij Këshilli**

Në zbatim të Ligjit Nr.9607, datë 11.09. 2006, “Për Këshillin Konsultativ të Biznesit”,
nenit 3 dhe 5, si dhe rregullores “Për Funkcionimin e Këshillit Konsultativ të Biznesit”,
nenit 5,6 dhe 11 në mbledhjen e datës 06.03.2008, Keshilli Konsultativ i Biznesit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit Vjetor të KKB-së për vitin 2007, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Miratimin e buxhetit të Keshillit Konsultativ te Biznesit për vitin 2008 sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

GENC RULI

Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

RAPORTI VJETOR 2007

PERMBAJTJA

✚ Objektivat vjetore te KKB

✚ Perberja e anetareve per vitin 2007

✚ Çeshtjet dhe temat e shqyrtuara ne KKB

✚ Rekomandimet e adresuara ne qeveri dhe komisionet
parlamentare

✚ Ndikimi i ketyre rekomandimeve ne ndryshimin e
legjislacionit

Objektivat vjetore te KKB

Keshilli Konsultativ i Biznesit per vitin 2007 ka pasur si objektiv konsultimin e politikave ekonomike, duke ndikuar ne permiresimin e kuadrit ligjor perkates ne Shqiperi. Duke ditur se pjese e KKB-se jane organizatat me perfaqesuse te biznesit, ky keshill ka dhene kontributin e tij ne lidhje me:

- procesin e hartimit te strategjive dhe programeve qeveritare te zhvillimit te ekonomisë;
- procesin e përgatitjes te paketave fiskale;
- politikat e nxitjes se investimeve;
- politikat e zhvillimit te tregtisë dhe biznesit;
- politikat e konkurrencës, mbikëqyrjes se tregut dhe mbrojtjes se konsumatorit.

Per çeshtje te caktuara, per probleme qe shqetesojne komunitetin e biznesit, KKB ka përgatitur rekomandime te ndryshme prane qeverise dhe parlamentit ne menyre qe te paraqese dhe te kontribuojne ne zgjidhjen e problemeve te biznesit privat ne Shqiperi. Pjese e temave dhe ceshtjeve te kaluara per diskutim ne KKB kane qene edhe ligje te ndryshme me efekte specifike ne jeten e biznesit, si: ligji per tatimin mbi te ardhurat, ligji per tvsh-ne, ligji per akcizat etj. Përveç projektligjeve te ardhura si pjese e paketave fiskale, KKB ka diskutuar projektligje qe jane nisma te METE-s, te cilat nen kujdesin dhe mbikëqyrjen e Drejtorise se Nxitjes Biznesit jane paraqitur ne KKB duke bere te mundur konsultimin e ketyre projektligjeve ne grupet e interesit te Biznesit Shqiptar. Nder to mund te permendim projektligjin “Për organizimin e Panaireve dhe Ekspozitave Tregtare”, “Për Shoqërite Tregtare”, “Për Nënshkrimin Elektronik” etj.

Perberja e anetareve per vitin 2007

Per vitin 2007, KKB nen drejtimin e Kryetarit Z.Genc RULI, Minister i Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, ka qene e perbere nga 18 anetare, ku pjese me madhe e ketyre antareve jane organizatat me perfaqesuese te biznesit ne Shqiperi. Keto organizata paraqiten ne tabelen e meposhtme se bashku me perfaqesuesit e tyre ne KKB.

Organizatat e Biznesit	Perfaqesuesi	Roli
Bashkimi i Dhomave te Tregtise	Ilir Zhilla	Anetar
Dhoma e Tregtise dhe Industrise Tirane	Gjoke Ulledaj	Anetar
Dhoma Amerikane e Tregtise	Genc Boga	Anetar

Dhoma e Tregtise Shqiperi-Britani e Madhe	Zenel Hoxha	Anetar
FIAA-Shoqata e Investitoreve te Huaj	Enyal Shuke	Anetar
Keshilli i Agrobiznesit Shqiptar	Enver Ferizaj	Anetar
Konfederata e Artizanatit Shqiptar	Petrit Metohu	Anetar
Shoqata Konfindustria Shqiptare	Luan Leka	Anetar
Qendra Shqiptare per TregtineNderkombetare/ACIT	Selim Belortaja	Anetar
Shoqata e Bankave	Elvin Meka	Anetar
Shoqata e Bashkive	Artur Kurti	Anetar
Shoqata e Ndertuesve	Behar Male	Anetar

Pjesa tjeter e antareve te KKB jane perfaqesuesit e institucioneve shteterore. Ministria e Financave perfaqesohet nga dy anetare; Zv.Ministri i Financave Z. Florjon MIMA, dhe Z. Sybi HIDA. Ky i fundit eshte larguar nga Shqiperia **dhe pritet zevendesimi i tij me nje tjeter perfaqesues nga Ministria e Financave**. Dy anetaret e tjere i perkasin Ministrise Ekonomise me perfaqesues z. Bashkim SYKJA, Drejtor i Nxitjes Biznesit dhe Z. Artan SAMARA, Zv.Drejtor i ALBINVEST. Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Perfaqesohet nga Znj. Aida SESERI, e cila nuk eshte paraqitur ne me shume se 4 (kater) mbledhje radhazi te KKB, **keshtu qe sipas rregullores do te kerkohet zevendesimi i ketij anetari**.

Ne mbledhjet e zhvilluara gjate vitit 2007 kane qene te pranishem pjesa me e madhe anetareve duke perjashtuar rastet kur disa anetare nuk kane marre pjese ne mbledhje per arsye te impenjimeve te tjera. Por, vlen te theksohet se, megjithese nuk kane qene te pranishem ne mbledhje keto anetare kane marre materialet e diskutuara dhe kane derguar ne rruge elektronike mendimet dhe sugjerimet e tyre.

Çeshtjet dhe temat e shqyrtuara ne KKB

Gjate vitit 2007, Keshilli Konsulativ i Biznesit (KKB) ka zhvilluar pese mbledhje ku jane diskutuar ceshtje te ndryshme lidhur me paketat fiskale te hartuara nga Ministria e Financave. Ne mbledhjet e KKB jane diskutuar 19 projektligje, projektvendime dhe programe strategjike, nder te cilat, disa jane nisma te METE-s, ku nder to eshte dhe diskutimi per projektligjin per Qendren e Regjistrimit te Biznesit, diskutimi mbi Draft-Strategjine e Biznesit dhe te Investimeve 2007-2013 etj. Pjesa tjeter e ketyre projektligjeve jane pjese e paketave Fiskale te ardhura nga Ministria e Financave. **Per vitin 2007 rezultojne te kaluara per shqyrtim ne KKB keto akte:**

1. Projektligji per Regjistrimin e Biznesit, te miratuar nga Keshilli i Ministrave me 14 mars 2007.
2. Draft-Strategjia e Biznesit dhe te Investimeve 2007-2013.
3. Per ndryshim ne Ligjin Nr. 9632 date 30.10.2006 “Per sistemin e Taksave Vendore”
4. Per ndryshim ne Ligjin Nr. 8976 date 12.12.2002 “Per akcizat ne Republiken e Shqiperise”
5. Per ndryshim ne Ligjin Nr. 8560 date 22.12.1999 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”
6. Per ndryshim ne Ligjin Nr. 8438 date 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te ardhurat”
7. Per ndryshim ne Ligjin Nr. 7928 date 27.04.1995 “Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar”, te ndryshuar.
8. Per ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 8782 date 3.05.2001, “Per Shoqerite e Kursim- Kreditit”.
9. Per ndryshim ne Ligjin Nr. 8438 date 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te ardhurat”, te ndryshuar.
10. Per ndryshim ne Ligjin Nr. 8788 date 7.05.2001 “Per Organizatat jofitimpruresë”
11. Per ndryshim ne Ligjin Nr. 7892 date 21.12.1994 “Per Sponsorizimet”, te ndryshuar.
12. Diskutim lidhur me projektligjin”Per Procedurat Tatimore
13. Diskutim mbi projektligjin “Për Shoqërite Tregtare”
14. Diskutim mbi projektligjin “Për Nënshkrimin Elektronik”
15. Diskutim mbi projektligjin “Për organizimin e Panairëve dhe Ekspozitave Tregtare”
16. Projekt-ligjin “Per krijimin dhe funksionim e zonave ekonomike”
17. Projektligji “Per bujqësinë dhe zhvillimin rural”
18. Projektligji “Per Cmimet ne ndertim”
19. Projektligji “ Per disa shtesa ne ligjin Nr. 8438, date 28. 12 .1998” Per tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar.

Duke pare se koha ne dispozicion per diskutimin e disa projektligjeve te mesiperme ka gene e shkurter, disa nga projektligjet e mesiperme u jane derguar ne rruge elektronike antareve te KKB, dhe pas sugjerimeve te derguara nga anetaret jane pergatitur rekomandimet perkatese per Qeverine dhe Parlamentin.

Rekomandimet e adresuara ne qeveri dhe komisionet parlamentare

Ne zbatim te detyrimeve ligjore qe rrjedhin nga ligji nr. 9607 date 11.09.2006 “ Per Keshillin Konsultativ te Biznesit, regullores se KKB miratuar nga Kryetari i KKB , Z. Genc RULI me Vendimin Nr. 1 date 28.12.2006, si dhe dhe angazhimit te KKB per dialog dhe konsultim te herepashershem me Shoqatat dhe perfaqesuesit e biznesit, gjate vitit 2007 pas çdo mbledhjeje te KKB-se, se bashku me minutat e mbledhjes jane percjellur per ne Keshillin e Ministrave dhe ne Ministrine e Financave rekomandimet perkatese per keto mbledhje.

Gjithashtu minutat e mbledhjes se KKB ku pasqyrohen mendimet dhe sygjerimet e dhena nga anetaret e KKB gjate cdo mbledhjeje, jane te pasqyruara ne sitin e internetit te Ministrise Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes ne rubriken e Keshillit Konsultativ te Biznesit. (<http://www.mete.gov.al/rub.php?idr=197&l=a>)

Gjate vitit 2007, jane derguar ne Keshillin e Ministrave kater rekomandime ku jane paraqitur sugjerimet per 12 projektligjet e meposhtme:

1. *Per projektligjin nr.8438, date 28.12.1998 “ Per tatimin mbi te ardhurat”:*
2. *Per projektligjin per ndryshimin e ligjit nr.9632, date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”*
3. *Per projektligjin per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise*
4. *Per projektligjin per Akcizat ne Republiken e Shqiperise*
5. *Per projektligjin per ndryshimin e ligjit nr. 7928 date 27.04.1995 “Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar”, te ndryshuar.*
6. *Per projektligjin per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr 8782 date 3.05.2001, “Per Shoqerite e Kursim-Kreditit”.*
7. *Per projektligjin per disa ndryshime ne Ligjin Nr 8788 date 07.05.2001 “Per Organizatat jofitimpruresë”*
8. *Per projektligjin per disa ndryshime ne Ligjin Nr 8438 date 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te ardhurat”, te ndryshuar.*

- Ne mbledhjen e dates 16.10.2007 eshte diskutuar lidhur me projektligjin “Per Procedurat Tatimore” dhe pas perfundimit te mbledhjes rekomandimi perkates i eshte derguar grupit te punes qe ka hartuar projektligjin ne menyre qe te behet rishikimi dhe perfshirja e sygjerimeve perpara se ky projektligj te shkoje per miratim ne Keshillin e Ministrave.

- Ne mbledhjen e dates 21.12.2007 ku jane diskutuar projektligjet;

9. “Për Shoqërite Tregtare”
10. “Për Nënshkrimin Elektronik”
11. “Për organizimin e Panairove dhe Ekspozitave Tregtare”,

U sugjerua qe per projektligjin per Shoqerite Tregtare te behet rishikimi i dispozitave te ketij projektligji per pergjegjesine personale te aksionereve, pra nese ortaket e shoqerise do te pergjigjen vetem me pasurine e tyre ne shoqeri apo, sebashku me pasurine e tyre vetjake. Lidhur me kete projektligj u sygjera rishikimi gjuhesor i ketij projektligji ne teresine e tij.

Per projektligjin “Për organizimin e Panairove dhe Ekspozitave Tregtare”, u vendos rishikimi i ketij projektligji per disa pjese te vecanta te tij duke rishikuar sygjerimet e e ardhura nga Dhoma e Tregtise dhe Industrise Tirane, si dhe anetaret e tjere te KKB-se. Gjithashu u vendos qe Qendra Kombetare e Panairove dhe Ekspozitave Tregtare e parashikuar ne projektligj si nje qender per organizimin, promovimin dhe mbikeqyrjen e veprimtarive te panairove te quhet Agjensia Kombetare e Panairove dhe Ekspozitave Tregtare.

Ndikimi i ketyre rekomandimeve ne ndryshimin e legjislacionit.

Rekomandimet e derguara ne adrese te Kryeministrise, Ministrise se Financave dhe Parlamentit kane pasur nje ndikim te rendesishem ne ndryshimin dhe permiresimin e projektligjeve te ardhura per diskutim ne Keshillin Konsultativ te Biznesit. Ne keto rekomandime jane perfshire te gjitha sygjerimet e derguara nga organizatat e biznesit te cilat jane diskutuar me pare ne anetaresine e ketyre organizatave me qellim per te kontribuar ne permiresimin e kuadrit ligjor ne interes te dy paleve, buxhetit dhe biznesit. Ne keto rekomandime jane perfshire dhe sygjerimet e ardhura ne adrese te KKB nga organizata te tjera biznesi, te cilat nuk jane anetare te KKB, por jane grupe biznesi te cilat prekeshin drejtperdrejt nga nderhyrja ne keto projektligje. Duke ditur kete fakt perfaqesuesit e ketyre organizatave jane ftuar te marrin pjese ne diskutimet e e zhvilluara gjate mbledhjes se KKB.

Duke u bazuar ne Fletoret Zyrtare te Vitit 2007 ne te cilat pasqyrohen ligjet te cilat ne statusin e projektligjit jane diskutuar ne KKB, rezulton se pjesa me e madhe e ketyre rekomandimeve kane pasur nje ndikim te rendesishem ne permiresimin e kuadrit ligjor. Sipas rekomandimeve te derguara per 12 projektligje, rezulton se **jane marre parasysht rekomandimet e derguara vetem per projektligjet e meposhtme:**

1. Projektligji per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise

Per kete projektligj eshte sygjereuar qe te saktesohej Neni 1 i ketij projektligji lidhur me atributet e Policise Tatimore. Duke ju referuar Nenit 1 te Ligjit 9767 date 9.7.2007, "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8560, date 22.12.1999 "Per procedurat tatimore ne republikën e shqipërisë", të ndryshuar", ky sygjerim eshte marre parasysh dhe eshte shtuar: "Procedura e dhenies se ketyre attributeve rregullohet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi".

2. Projektligji per Akcizat ne Republikën e Shqipërisë

Per kete projektligj eshte sygjereuar qe te hiqet akciza e veres per prodhuesit vendas ose te ulet nekrahahim me veren e importit. Duke ju referuar Shtojces 1 qe i bashkelidhet Ligjit Nr.9765 date 9.7.2007 "Per disa ndryshime ne ligjin Nr.8976 date 12.12.2002" Per Akcizat" te ndryshua, rezulton se akciza per veren e vendit nga 50 leke/liter qe ishte parashikuar eshte bere 20 leke/liter per sasi <=1000 hektoliter/vit dhe 35 leke/liter per sasi >1000 hektoliter/vit.

3. Projektligji per ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr 8782 date 3.05.2001, "Per Shoqërite e Kursim-Kreditit".

Per kete projektligj eshte sygjereuar qe Neni 52, ekzistues ne ligjin e meparshem te mos shfuqizohet. Duke ju referuar Ligjit Nr. 9762 date 25.06.2006 "Per nje ndryshim ne Ligjin Nr.8782 date 3.05.2001 "Per Shoqërite e Kursim-Kreditit" rezulton se Neni 52 nuk eshte shfuqizuar.

Lidhur me projektligjet per

4. "Per Procedurat Tatimore",
5. "Për Shoqërite Tregtare",
6. "Për Nënshkrimin Elektronik"
7. "Për organizimin e Panairove dhe Ekspozitave Tregtare",

sygjerimet dhe rekomandimet e KKB-se jane perfshire qe ne fazen e hartimit te ketyre projektligjeve nga grupet hartuese te tyre.

Me poshte paraqitet bilanci i akteve te shqyrtuara ne KKB gjate viti 2007.

	Numer	Perqindja
Akte te shqyrtuara ne KKB	19	100%
Akte per te cilat jane derguar rekomandime	12	63%
Akte per te cilat jane marre parasysh rekomandimet	7	58%